

VENDIM
Nr.7, datë 6.1.2011

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS DARDHAS TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Dardhas, të qarkut të Korçës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 72 (shtatëdhjetë e dy) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 452 (katërqind e pesëdhjetë e dy).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Dardhas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Dardhas

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
32-44	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
25-31	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
1-4	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
5-24	Varrezat publike	Në pronësi
45	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative	Në pronësi
46-54	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
343-362	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
363-380	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
381-400,414,416	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka jo produktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
419-427	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi